



Në pajtim me nenin 18 të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, Ligji Nr: 03/L-216 (i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 15 të Ligjit Nr: 04/L-133), Fondi për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK), më datë 30.03.2026, publikon si më poshtë:

### **Shpallje për pozitën:**

**Anëtar jo-ekzekutiv i Bordit Menaxhues të FSDK-së, ekspert, auditor i certifikuar me përvojë, me mandat pesë vjeçar.**

#### **Profili i kërkuar:**

- I/E njohur për standard të lartë të integritetit dhe reputacionit;
- Arsimim të lartë profesional në çështje financiare, bankare apo ligjore;
- Arsimim profesional për auditor të certifikuar në përputhje me paragrafin 2, të nenit 30 të Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe auditim;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale/akademike në fushën e auditimit si dhe në çështje bankare, financiare apo ligjore;
- Minimum pesë (5) vite përvojë profesionale si auditor i certifikuar;
- Pa asnjë mandat politik, aktualisht apo në vitin paraprak;
- Gjatë vitit paraprak pa histori punësimi apo angazhimi si drejtues ose anëtar i Bordit Drejtues në ndonjë institucion financiar që pranon depozita në Kosovë, anëtar të FSDK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojë kriteret e përshtatshmërisë sipas nenit 20, paragrafët 1.1-1.4 Ligji Nr: 03/L-216;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera paraqet përparësi.

Përgjegjësitë si anëtar i Bordit do të përfshijnë përgjegjësitë e përcaktuara me Nenin 19 të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, Ligji Nr: 03/L-216 (i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 16 të Ligjit Nr: 04/L-133):

- Emërimin e Drejtorit Menaxhues të FSDK-së;
- Lidhjen e kontratave dhe të jetë palë në procedura ligjore;
- Marrjen, mbajtjen dhe heqjen dorë nga prona e FSDK-së;
- Miratimin e të gjitha rregullave, urdhëresave dhe udhëzimeve për menaxhimin dhe operimin e FSDK-së;
- Miratimin e planit financiar dhe pasqyrat financiare të FSDK-së ;
- Miratimin e Politikës për investime të FSDK-së;
- Marrjen e vendimeve për ndryshimin e nivelit të premuimeve të sigurimit;
- Rekomandoj ndryshime në Ligjin për Sigurimin e Depozitave ;
- Plotëson kushtin për pjesëmarrje në takim të Bordit sipas nenit 21, paragrafi 7 të Ligjit mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë, Ligji Nr: 03/L-216;
- Miratimin e emërimit të auditorit të jashtëm të FSDK-së;
- Miratimin e metodave të pagesave për kompensim të depozitorëve në ngjarje të siguruar apo miratimin e shfrytëzimit të fondeve lidhur me bartjen e detyrimeve në proces të zgjidhjes së ndonjë banke;
- Vlerësimin e dënimeve dhe zbatimin e masave detyruese;
- Miratimin e huazimeve për FSDK-në;
- Miratimin e numrit të personelit të FSDK-së.

#### **Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet në vijim:**

1. CV të detajuar.
2. Letrën motivuese ku theksohet interesimi për pozitën.
3. Diplomën universitare dhe certifikatat tjera relevante (kopje).
4. Certifikimin e Auditimit në përputhje me paragrafin 2, të nenit 30 të Ligjit nr 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
5. Formularin “Deklaratë nën betim” të plotësuar dhe nënshkruar (i qasshëm në linkun [www.fsdk.org/sq/njoftimet/konkurse-pune](http://www.fsdk.org/sq/njoftimet/konkurse-pune)).
6. Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse.
7. Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Republikës së Kosovës.

#### **Si të aplikoni:**

- Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë kalendarike nga data 30.03.2026 deri me 14.04.2026.
- Mund të aplikoni përmes postës elektronike në adresën: **[FSDKkomisioni@fsdk.org](mailto:FSDKkomisioni@fsdk.org)** ose të dorëzoni fizikisht dosjen tuaj në adresën e FSDK-së: Rr. Bekim Fehmiu, nr.31, kati i I-rë, Lakërishtë , 10 000 Prishtinë.

**Aplikacionet e pa kompletuara me 7 dokumentacionet e lartpërmendura nuk do të merren parasysh nga komisioni. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen për intervistë.**